

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE KORRIK-SHTATOR 2025

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	16.06.2025	Kerkese per heqjen e shtepise nga Regjistri i Monumenteve te Kultures	02.07.2025	Ne vijim te kerkeses suaj me objekt " <i>Kerkese per heqjen e shtepise nga Regjistri I Monumenteve te Kultures</i> " , drejtuar MEKI-t, percjelle per trajtim dhe administruar prane IKTK-se me Nr. 736 prot., date 11.04.2025 si dhe ne vijim te pergjigjes se kthyer elektronikisht ne date 15.06.2025, ju informojme se, Prane IKTK-se eshte percjelle relacioni i hartuar nga DRTK Vlore, sektori i Sarandes, pas inspektimit te realizuar ne terren dhe tashme procedura e vleresimit te kerkeses suaj do te vijoje sipas dispozitave ligjore te Ligjit Nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete".	E plotë	Jo
2		Kerkese per te vënë në dispozicion një listë (perskrim te shkurter dhe foto per secilin zbulim) me zbulimet më të reja arkeologjike, per emisionin e të veçantë pullash.		Në vijim të kërkesës së Postës Shqiptare, gjeni bashkeldidhur foto të objekteve arkeologjike dhe fotot te Termes së Belshit.  Objekte arkeologjike (Pulla)  Terma e Belshit (Pulla) (1).docx	E plotë	Jo
3	15.07.2025	Kerkese per godinën e “Ish-Prefekturës” në Vlorë, mbi ecurne e kerkeses per restaurim	15.07.2025	Ne vijim te emailit tuaj, propozojme qe inspektimi ne terren te realizohet me date 17 korrik 2025 , ku prezente do te jene specialiste nga Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore dhe nga Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Vlore, te cilet do te kryejne nje inspektim te objektit me qellim hartimin e nje projekti per nderhyrje konservuese dhe restauruese. Ju lutem konfirmoni qe do te mundesohet akses i plote ne ndertese.	E plotë	Jo
4	15.07.2025	Informacion ne lidhje me aplikimin e lejes per nje instalacion/monument ne burgun e Spacit	28.07.2025	Ne pergjigje te kerkeses suaj te dates 15.07.2025, ju bejme me dije se, pasuria kulturore "Burgu i Spacit" eshte monument kulture i kategorise se II-te, i shpallur nga Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise e Sporteve me Urdher Nr.656, date 05.12.2007.		

				Si i tille eshte subjekt dhe i nenshtrohet percaktimeve ligjore te Ligjit Nr.27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe muzete", si dhe Urdhërit të Ministrit të Kulturës Nr. 297, datë 31.07.2015, “Per shpalljen e zonave te mbrojtura te monumenteve te kultures”, i cili citon se: Zona e mbrojtur e monumentit të kulturës konsiderohet sipërfaqja e truallit brenda kufirit të pronës në të cilën ndodhet monumenti.Sa me siper, Ligji Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 77, Pika 2 ç) përcakton se:"Kryhen vetëm me leje të Keshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM): gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në pasuritë kulturore, si dhe çdo ndërhyrje në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre". Ju mund ti drejtoheni subjekteve të licencuara në fushën e projektimit me licencën përkatëse në restaurim, në mënyrë që të hartojë dhe aplikojë në sportelin unik të KKTKM-së, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Aplikimi kryhet nëpërmjet portalit E-Albania, duke përdorur shërbimin "Leje për ndërhyrje në pasuri Kulturore Materiale". Subjekti aplikues, mund të aksesojë këtë shërbim në linkun e mëposhtëm: https://ealbania.al/ealbaniaServices/UseService.aspx?servicecode=13702 për vijimin e procedurës së shqyrtimit deri në vendimarrjen e KKTKM-së.		
5	15.07.2025	Kerkese per aprovim per nderhyrje ne objekt	22.07.2025	Në vijim të kërkesës suaj të dates 15.07.2025, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) me Nr. 1390 Prot., datë 17.07.2025, me objekt "Kërkesë për aprovim për ndërhyrje në objekt”, ju bëjmë me dije se: Objekti i kërkesës suaj ndodhet brënda kufirit të Qendrës Historike të qytetit të Korçës, shpallur si e tillë me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 207, datë 15.3.2017 “Për Shpalljen e Qendrës Historike të Qytetit të Korçës dhe Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen, Konservimin e		

				Integruar dhe Administrimin e Saj e të Zonës së Mbrojtur Përreth". Qendra Historike, si pasuri kulturore është subjekt i ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", i cili në Nenin 77, pika 1 e tij citon se: 1.Çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme kryhet vetëm pas miratimit nga ana e KKTKM-së ose ministrit, sipas rastit të ndërhyrjes në pikën 3, të këtij neni, referuar intensitetit të ndërhyrjeve të parashikuara në kartelën e pasurisë. Për sa më sipër, çdo ndërhyrje në pasuri kulturore duhet të jetë konform Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe kriterëve të përcaktuara në VKM Nr. 207, datë 15.3.2017. Duke Ju falënderuar		
6	16.07.2025	Kerkese per informacion mbi punimet ne zonen historike, Berat	25.07.2025	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (ne vijim IKTK) ka trajtuar ne vazhdimësi kërkesat e Z. _____, i cili shpreh shqetësimin e tij ne lidhje me ndërhyrjet e bëra ne pronën e z. _____. Banesa e Z._____ ndodhet në lagjen Mangalem të qytetit të Beratit dhe gëzon statusin Monument Kulture kat. II-të (M-004) shpallur me Urdhër Nr.149, datë 17.04.2015 të Ministrisë së Kulturës. • Fillimisht këto ndërhyrje kane qene te paaautorizuara prandaj me vendimin nr.345, date 13.09.2024 Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale ka vendosur mosmiratimin e këtij projekt-propozimi. Për këtë fakt IKTK, ne zbatim te dispozitave te Ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" ka vijuar procedurën ne lidhje me njoftimin e instancave shtetërore përkatëse, duke u marre te gjitha masat e duhura, deri ne prishjen e këtyre ndërhyrjeve; • Projekti "Restaurimi, përshtatje dhe ndërhyrje plotësues në banesën në pronësi te Z. _____ M-004, lagjja Mangalem - Berat" është shqyrtuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), në mbledhjen e datës 14.02.2025, i cili vendosi me Vendim nr. 106, datë 14.02.2025:	E plotë	Jo

				- Shtyrjen e Vendimmarrjes për projektin "Restaurimi, përshtatje dhe ndërhyrje plotësues në banesën në pronësi të Z. Jorgji Fani M-004, lagjja Mangalem - Berat", Monument Kulture i Kategorisë së II-të, Brenda Kufirit Qendër Historike të qytetit të Beratit, me aplikues dhe zhvillues Z. _____ me argumentin: - Të depozitohet një variant i dytë projekti, në të cilin fasadat të kenë elemente të stilit tradicional të Qendrës Historike Berat; - Në vijim të kërkesës së sipërcituar nga Këshilli Kombëtar, aplikuesi ka depozituar në sistemin e-lejet në datë 07.03.2025 një variant të ri të projektit. Ne këtë propozim vihet re që elementet e fasadave i përkasin stilit tradicional të Qendrës Historike Berat. Referuar këtij konstatimi, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, me vendimin nr. 169, datë 13.03.2025, vendosi miratimin e ndërhyrjeve plotësuese të këtij projekti. Për sa me sipër, në lidhje me ndërhyrjet në këtë prone, z. Gjogu është informuar se ato janë të miratuara me Vendim nga një Organ Kolegjial vendimmarrës (KKTKM) dhe IKTK nuk ka kompetencë ligjore mbi interpretimin e tyre. Se fundmi IKTK evidenton se kërkesat/ankesat e z. Gjogu janë shqyrtuar dhe vonesat që citohen të e-mail e tij janë për shkak se IKTK është në komunikim të vazhdueshëm me DRTK Berat, mbi ecurinë dhe përcjelljen e konstatimeve rast pas rasti në lidhje me këtë problematik të ngritur prej tij.		
7	17.07.2025	Kerkese per informacion në lidhje me eksplorimin rekreativ të plazheve në Shqipëri.	17.07.2025	Duke ju falënderuar si fillim për interesin që ju keni shprehur në lidhje me eksplorimin rekreativ të plazheve në Shqipëri, Ju bëjmë me dije se: Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore ushtron veprimtarinë e tij sipas Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", dhe ka si mision ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore kombëtare, trashëgimisë kulturore muzeore, peizazhit, si kontribues në ruajtjen e kujtesës kombëtare, përfaqësimit material dhe të dukshëm të identitetit kombëtar, si shprehje e vlerave kulturore, si dhe nxitja e zhvillimit kulturor në vend, duke siguruar dhe parandalimin e trajtimit të paligjshëm të objekteve kulturore.	E plotë	Jo

				Sa me siper, me qellim trajtimin e kerkeses suaj, ju mund te drejtoheni ne Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit, ne adresen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit .		
8	18.07.2025	Kerkese per listen e objekteve te vjetra kryesisht vilave te ndodhura ne Tiranë.	22.07.2025	Në vijim të emailit Tuaj, dërguar në adresën zyrtare të IKTK-së, në datën 18.07.2025, me anë të të cilit jeni drejtuar me disa pyetje sipas pikave në lidhje me objektet me status Monument Kulture, kryesisht vilave në Tiranë, Ju bëjmë me dije si më poshtë: <i>Sa objekte në total ka aktualisht në Tiranë me këtë status?</i> Përsa i përket objekteve me status Monument Kulture, lista e objekteve me status për secilin qark gjendet e publikuar në faqen zyrtare të IKTK. Në linkun bashkëlidhur do të gjeni listën e objekteve me status Monument Kulture në Qakun e Tiranës, Bashkinë Tiranë dhe Njësitë Administrative, të cilat janë të ndara sipas kategorisë (kategoria e I-rë dhe kategoria e II-të) dhe me emërtimin e objektit (banesa, kala, etj.). Më poshtë linku: https://iktk.gov.al/site/wp-content/uploads/2024/09/Qarku-Tirane.pdf <i>Mbi ç'baza një objekt e humb statusin e monumentit të kulturës, cilat janë kriteret?</i> Humbja e statusit të monumentit të kulturës bazohet në legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore, konkretisht Ligji Nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe në aktet nënligjore të tij. Ky është një proces shumë delikat dhe kërkon një dokumentim të saktë dhe në vijim një studim të mirëfilltë nga ekspertë të specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore, i cili do të argumentonte një kërkesë të tillë. Kriteret që merren në konsideratë për mungesën e interesit kulturor kryesisht lidhen me: -humbjen e vlerave kulturore-historike të objektit; -humbjen e vlerave arkitektonike-artistike të tij. Nëse vlerësimi i ekspertëve të fushës argumenton se objekti monument kulture i ka humbur vlerat për të cilat është deklaruar pasuri kulturore, procedura vijon sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe finalizohet me Urdhrin e Ministrit, për mungesë të interesit kulturor.		

			<i>Nga 2020 deri në 2025 sa objekte e kanë humbur këtë status? A mund të na jepni një ose dy shembuj objekte dhe arsytimin kur e kanë humbur këtë të drejtë dhe argumentimin?</i> Nga viti 2020 deri në vitin 2025 janë 4 (katër) objektet që e kanë humbur statusin Monument Kulture: Në vitin 2020 ka humbur statusin e Monumentit të Kulturës- "Banesë tip vilë 2 kate (II-149), lagjja nr. 7, rruga "Mihal Duri", Tiranë", shpallur Monument Kulture i kategorisë së II-të me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr 276, datë 16.07.2015 "<i>Për shpalljen monument kulture të kategorisë së II-të disa objekteve në qytetin e Tiranës</i>"; Në vitin 2021 ka humbur statusin e Monumentit të Kulturës- "Banesë tip vilë 1 kat, rruga "Dervish Hekali" (II-209), Tiranë", shpallur Monument Kulture i kategorisë së II-të me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr 276, datë 16.07.2015 "<i>Për shpalljen monument kulture të kategorisë së II-të disa objekteve në qytetin e Tiranës</i>"; Në vitin 2023 ka humbur statusin e Monumentit të Kulturës- "Godina e Postë Telegraf (II-62) rruga "Dëshmorët e 4 Shkurtit", Tiranë", shpallur Monument Kulture i kategorisë së II-të me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr 122, datë 05.03.2007 "<i>Për shpalljen Monument Kulture të kategorisë së dytë të ndërtesave në aksin kryesor të Qendrës Historike të qytetit të Tiranës</i>"; Në vitin 2024 ka humbur statusin e Monumentit të Kulturës- "Banesë kolektive, 2 kate (kod II-196), rruga "Tefta Tashko", Bashkia Tiranë", shpallur Monument Kulture i kategorisë së II-të me Urdhrin e Ministrit të Kulturës nr 276, datë 16.07.2015 "<i>Për shpalljen monument kulture të kategorisë së II-të disa objekteve në qytetin e Tiranës</i>"; Humbja e statusit "Monument Kulture" i këtyre objekteve ka ardhur si pasojë e humbjes së pakthyeshme të vlerave kulturore dhe arkitekturore/historike të tyre pas vlerësimit të ekspertëve të specializuar në fushën e trashëgimisë kulturore i cili vërteton mungesën e interesit kulturor. <i>Çfarë do të ndodhë me monumentet e tjera që kanë mbetur por janë duke u rrënuar dita ditës?</i> <i>A ka buxhet të përcaktuar për ndërhyrjen dhe restaurimin e tyre?</i>		
--	--	--	--	--	--

				Institucionet përgjegjëse, si Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, kryejnë inspektime periodike për të vlerësuar gjendjen e konservimit të pasurive kulturore që kanë nën administrim. Në bashkëpunim dhe koordinim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, sipas rastit vijohet me ndërhyrje mirëmbajtëse, hartim projekt konservimi/restaurimi dhe sipas shkallës së degradimit apo prioriteteve në rang kombëtar perfshihen në listën e objekteve në risk të cilat përcillen çdo vit pranë Ministrisë së Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit, për t'u përfshirë në planin e buxhetit afatmesëm. Sjellim në vëmendje se mbrojtja e trashëgimisë kulturore është një proces i rëndësishëm, i cili kërkon angazhimin e të gjithë palëve duke përfshirë banorët, komunitetin, institucionet e specializuara, pushtetin vendor dhe atë qendror.		
9	21.07.2025	Kerkese per investim ne lidhje me kerkesen per degradimin e objektit muze “Shkolla e Pare Shqipe” ne Pogradec.	06.08.2025	Ne vijim te kerkeses suaj si dhe referuar inspektimit te bere ne terren nga Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore, Korçe, Ju informojme si vijon: Objekti te cilit ju i referoheni me emertimin "Shkolla Shqipe ne Pogradec" nuk gezon status pasuri kulturore, por ndodhet brenda Qendres Historike te qytetit te Pogradecit, shpallur kjo e fundit me Vendim te Keshillit te Ministrave <i>"Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të pogradecit dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj"</i>. DRTK Korçë nuk ka plan financimi nga buxheti i institucionit per objektin ne fjale! Ne vazhdimesi te projektit te restaurimit te Qendres Historike Pogradec, sugjerojme te kerkohet informacion nga Bashkia Pogradec mbi planin e nderhyrjes ne kete objekt.	E plotë	Jo
10	21.07.2025	Kërkesë për saktësim vendimi	22.07.2025	Në vijim të email-it tuaj, dërguar në adresën zyrtare të IKTK në datën 21.07.2025, ku kërkonte saktësim të Vendimit të KKTKM-së nr. 293, datë 09.08.2024, pasi Bashkia Durrës nuk e njeh këtë vendim në formën e lëshuar, dhe në lidhje me pretendimet e zyrës së Urbanistikës se në Vendimin e saj KKTKM-së duhet të shprehet dhe për miratim të projektit, jo vetëm të Raportit të Potencialit Arkeologjik, ju bëjmë me dije se: Bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 27/2018 <i>"Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"</i> dhe VKM-në nr. 786, datë 26.12.2018 <i>"Për zonifikimin arkeologjik të qytetit të Durrësit"</i>, IKTK dhe më pas Këshilli Kombëtar	E plotë	Jo

				i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), shqyrton dhe vlerëson çdo propozim për ndërhyrje në zonat arkeologjike "A" dhe "B" të qytetit të Durrësit, duke marrë në konsideratë impaktin e secilit propozim mbi pasurinë arkeologjike të zonës. Pas çdo shqyrtimi, KKTKM duke vlerësuar propozimin mbi bazën ligjore në fuqi, si dhe në varësi të shkallës së impaktit mbi zonën arkeologjike, del me vendimin përkatës dhe rekomandime nëse vlerësohet e nevojshme. Sqarojmë gjithashtu se, Vendimi i KKTKM është një dokument i cili vlerëson ndërhyrjet në pasurinë kulturore (zonën arkeologjike në këtë rast) dhe nuk është leje ndërtimi, për të cilën është kompetente Bashkia Durrës. Sjellim në vëmendje raste analoge, ku me të njëjtën përmbajtje të vendimeve të KKTKM-së, Bashkia Durrës ka vijuar me procesin e zbardhjes së lejes së ndërtimit.  SignEd_VEndimNr2 93datE09082024Rap		
11	31.07.2025	Kerkese per aistence mbi projektin artistic te mjeshtrove te fotografise ne shqipëri edhe emra te njohur qe kujdesen per trashëgiminë kulturore.	01.08.2025	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), ushtron veprimtarinë e tij si institucion i specializuar ne fushën e trashëgimisë kulturore, ne varësi te Ministrisë se Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, ne zbatim te Ligjit nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" dhe financohet nga buxheti i shtetit. Buxheti i akorduar për vitin 2025 është i mire shpërndarë ne mënyre specifike me qellim realizimin e shërbimeve te institucionit ne funksion te ushtrimit te veprimtarisë se tij. Për këtë arsye IKTK e ka te pamundur qe te ofroje një mbështetje financiare ne kuadër te realizimit te projektit tuaj. IKTK shpreh gatishmërinë ne lidhje me suportin qe mund te ofroje për sa i përket informacionit arkivor. Nëse ju do te keni nevojë për dokumentacion arkivor, mund te drejtoheni ne këtë adrese dhe IKTK ne zbatim te ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, do te vendos ne dispozicionin tuaj informacionet e kërkuara.	E plotë	Jo
12	30.07.2025	-Si paraqitet gjendja e monumenteve të kulturës në zonën e Thethit sipas inspektimeve të fundit të bëra në terren nga	06.08.2025	Ne vijim te komunikimeve ne lidhje me informacionin e kërkuar, ju informojme si vijon:	E plotë	Jo

		institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore? -Sa prej këtyre monumenteve janë restauruar plotësisht në pesë vitet e fundit? - Sa prej këtyre monumenteve kanë projekte të miratuara restauruese dhe janë në pritje të zbatimit të tyre? -Sa prej monumenteve aktualisht kanë nevojë për restaurim? - Çfarë lloj ndërhyrjesh (restaurim konservativ, restaurim i plotë, riparime të lehta) janë realizuar në monumentet e kulturës në Thethit në pesë vitet e fundit?		1. Si paraqitet gjendja e monumenteve të kulturës në zonën e Thethit sipas inspektimeve të fundit të bëra në terren nga institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore • Kulla e Lulash Keçit; Nga inspektimi I fundit me dt.08.07.2025 u konstatua se monumenti është në gjendje të mirë, si nga çatia me furde, muret dhe fasadat nga jashtë, vetëm interior ka nevojë për ndërhyrje mirëmbajtëse. • Kulla e Ngujimit (Nikoll Koçeku); Nga inspektimi I fundit me dt.08.07.2025 u konstatua se monumenti është në gjendje të mirë, si nga çatia me furde, muret dhe fasadat nga jashtë, vetëm interior ka nevojë për ndërhyrje mirëmbajtëse. • Kulla Ndue Kola rezulton në gjendje shumë të mirë. • Vendbanimi Prehistorik I Sistemit Tarracor i Grunasit. Gjendja e sitit arkeologjik paraqitet e mire. Ka nevojë për pastrim sistematik të vegjetacionit dhe sinjalistik informuese pasi orientuese ekziston. 2. Sa prej këtyre monumenteve janë restauruar plotësisht në pesë vitet e fundit? Gjatë 5 viteve të fundit nuk ka patur asnjë restaurim të plotë nga DRTK Shkoder. 3.Sa prej këtyre monumenteve kanë projekte të miratuara restauruese dhe janë në pritje të zbatimit të tyre? Referuar pikes 7 te nenit 79 te Ligjit nr. 27/2018 "per trashëgimine kulturore dhe muzete", ne lidhej me afatete dhe vlefshmerine e lejes ose Vendimit te dhene nga ana e KKTKM-se, bejme me dije se aktualisht nuk ka asnje projekt të miratuar qe te jete ne fuqi sipas ketyre afateve. 4.Sa prej monumenteve aktualisht kanë nevojë për restaurim? Objektet qe gezojne statusin pasuri kulturore, te cituara edhe me siper, referuar terrenit, kushteve atmosferike apo mungeses se mirembajtjeve here pas here bejne qe ato te kene nevojte sistematike per nderhyrje dhe mirembajtje te struktures se tyre. 5.Çfarë lloj ndërhyrjesh (restaurim konservativ, restaurim i plotë, riparime të lehta) janë realizuar në monumentet e kulturës në Thethit në pesë vitet e fundit?	
--	--	---	--	--	--

				Gjatë 5 viteve të fundit nga IKTK dhe DRTK Shkoder, nuk janë zbatuar projekte restaurimi, të plota apo të pjesshme.		
13	13.08.2025	Kerkese per te bere filmime ne digen e Fierzes	13.08.2025	Ne vijim te kerkeses suaj, ju informojme si vijon: Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore (IKTK), ushtron veprimtarine e tij sipas percaktimeve te Ligjit nr. 27/2018 "Per trashegimine kulturore dhe muzete" dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij. Hidrocentrali i Fierzës i ndërtuar mbi lumin Drin në afërsi të fshatit Fierzë, nuk gezon statusin pasuri kulturore, apo te kete zone te mbrojtur rreth tij. Nderkohe kerkesa juaj konsiston ne marrjen e lejes per për të zhvilluar një nga sfidat e programit te planifikuar nga ana juaj. Per sa me siper bejme me dije se kjo kerkese nuk eshte kompetence e IKTK-se.	E plotë	Jo
14	13.08.2025	Kerkese per materiale arkivore per objektin e Kulla e familjes Rupa ne Theth, e cila njihet edhe si Kulla Dede Ndou.	19.08.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “<i>Për Arkivat</i>” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>”, Ju bejme me dije se nga verifikimi i kryer ne Arkivin Teknik nuk disponojme dokumentacionin arkivor per objektin Kulla e familjes Rupa ne Theth, e cila njihet edhe si Kulla Dede Ndou. Nga database e arkivit rezulton se kemi nje kulle me te njetin mbiemer me emertimin "Kulla e Nik Ndou", Theth, e cila prej vitit 1987 i eshte hequr statusi "Monument kulture" me Urdher te Ministrit te Kultures dhe Arteve Nr. 8, date 18.12.1987. Nga komunikimi i kryer, po ju vendosim ne dispozicion kopje digjitale te materialeve arkivore te dosjes teknike te "Kulles Nik Ndou" ne Theth, si dhe aktet ligjore te deklarimit dhe te mungeses se interesit kulturor, me qellim saktesimin e informacionit. Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "<i>Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to</i>", duke qënë se krijimet grafike dhe fotografike janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit, lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur te perdoren dokumentat arkivor. https://www.transfernnow.net/dl/20250819VfFoCW0l	E plotë	Jo
15	23.08.2025	Kërkesë për Informacion në lidhje me zbulimet arkeologjike në vendin ku më parë ngrihej Gjimnazi “Gjergj Kastrioti” në Durrës.	03.09.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion të datës 23.08.2025, sqarojmë si vijon: 1. - Puna për vlerësimin e deklarimit të interesit kulturor në lidhje me zbulimet arkeologjike të kryera në kuadër të	E plotë	Jo

				projektit për rindërtimin e shkollës Gjergj Kastrioti”, Durrës është në proces. 2. - Nga ana e Subjektit të licencuar në arkeologji, po punohet me përgatitjen e dokumentacionit teknik të punës konservuese dhe për të gjithë procesin në tërësi në përputhje me kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Kriteve të Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut të miratuar me vendim nr.2 datë 30.01.2009. 3. - Në lidhje me pyetjen nr. 3, lutemi nga ana Juaj të jeni më të qartë dhe specifike në kërkesën e paraqitur. 4. - Sa i përket konservimit, pas përfundimit të gërmimit arkeologjik, është kryer procesi standard post-gërmim, i njëjtë me atë që aplikohet gjatë projekteve kërkimore – shkencore të Institutit të Arkeologjisë, duke mbuluar strukturat me gjeotekstil dhe sipër tij, me dheun e nxjerrë nga gërmimi. Po ashtu, për mozaikët është kryer konsolidimi paraprak i tyre dhe po ashtu mbulimi me gjeotekstil.		
16	08.09.2025	Kërkesë në lidhje me projektin zhvillimor “Ksamil Seaside Resort & Residential, The Mirrors, Faza I”, në Njësinë Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë,	10.09.2025	Ne vijim te kërkesës suaj, lidhur me projektin “Ksamil Seaside Resort & Rezidencial, The Mirrors, Faza I”, në Njësinë Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë, Ju bëjmë me dije si vijon: A është kërkuar mendim nga IKTK lidhur me lejen e zhvillimit për këtë projekt? Nëse po, cilat janë dokumentet, relacionet ose vendimet e dhëna nga IKTK? A ka dhënë vendim Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) për këtë projekt? Nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopjen e tij. - Referuar kontrollit të kryer në datë bazën e Sekretarisë Teknike të IKTK, nuk rezultoi të jete protokolluar një kërkesë për mendim apo kërkesë për shqyrtim të Raportit të Vëzhgimit Arkeologjik lidhur me projektin “Ksamil Seaside Resort & Residential, The Mirrors, Faza I”, në Njësinë Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë. A është kryer ndonjë studim arkeologjik paraprak në territorin e parashikuar për ndërtimin e resortit? - Ne IKTK nuk është administruar asnjë dokumentacion lidhur me këtë projekt. A janë evidentuar në këtë zonë ose në afërsi gjurmë arkeologjike, monumente kulture apo objekte me vlera historike? Nëse po, cilat masa janë rekomanduar për ruajtjen, konservimin dhe dokumentimin e tyre?	E plotë	Jo

				• <i>Ne IKTk nuk është administruar asnjë dokumentacion lidhur me këtë projekt.</i> A ka parashikuar IKTk një plan monitorimi arkeologjik për fazën e ndërtimit të këtij projekti? • <i>Ne IKTk nuk është administruar asnjë dokumentacion lidhur me këtë projekt dhe çdo plan monitorimi që IKTk parashikon lidhet me vendimmarrjet e KKTKM sipas dispozitave ligjore në fuqi.</i>		
17	11.09.2025	Kerkese per informacion nese nje pasuri ne pronesi private e klasifikuar si monument kulturor te kategorise II dhe per te cilen subjekti privat eshte pajisur me leje ndertimi per rikonstruksion me ndryshim funksioni, mund te vendoset si barre per sigurimin e nje detyrimi?	18.09.2025	Ne vijim te kërkesës suaj, Ju informojmë si vijon: - Pasuritë e paluajtshme që janë monumente kulture janë të mbrojtura nga ligji nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Edhe pse janë në pronësi private, mbi to ekzistojnë kufizime të posaçme për përdorim, administrim, dhe çdo ndërhyrje bëhet vetëm me miratimin e institucioneve përkatëse. Leja e ndërtimit për rikonstruksion nuk e heq statusin e mbrojtjes si monument kulture. Për sa i përket vendosjes së barrës së sigurimit (kolateral, peng, detyrim), bëjmë me dije se një pasuri monument kulture në pronësi private mund të shërbejë si objekt barrë sigurorese, por me kusht që ky veprim të mos çënojë statusin ligjor dhe mbrojtjen e saj si monument kulture. Palët duhet të respektojnë kufizimet që rrjedhin nga ky status.	E plotë	Jo
18	24.09.2025	Kerkese per materiale arkivore per objektet Kalaja e Delvinë, Delvinë dhe 'Kalaja e Ali Pashës', Mahalla	29.09.2025	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTk-së, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju bejme me dije se: Ne Arkivin Teknik të IKTk-se lidhur me objektet pasuri kulturore "Kalaja e Delvines" dhe Kalaja e Ali Pashes", Mahalla disponojme dokumentacionin arkivor të mëposhtem: • Rilevime të objektit; • Nderhyrje restauruese ndër vite; • Foto historike. Sa me siper, ne kuader te hartimit te projekteve te restaurimit, ju dergojme bashkelidhur dokumentacionin arkivor per objektet ne studim. https://www.transferxl.com/it/download/08jf3HW8nNxV3k - Kalaja e Delvines	E plotë	Jo

				https://www.transferxl.com/it/download/08jBWz60s7VWmp - Kalaja e Ali Pashes, Mahalla		
--	--	--	--	--	--	--